



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

### VENDIM PARAPRAK

Nr. 316, datë 14.06.2023

#### PËR

### PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË, NË POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 537, DATË 17.11.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 14.06.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për propozimin paraparak për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Klodian Kurushi,

#### V Ë R E N

### I. TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji<sup>1</sup>, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit

<sup>1</sup> Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; - Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”; - Vendimin nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; - Vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”; - Vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi

gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësisimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë për dy pozicione të lira, në fushën e të drejtës civile, respektivisht me Vendimet nr. 536 dhe nr. 537 datë 17.11.2021.

2. Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, brenda afateve respektive të kandidimit, kandiduan **gjithsej 5 (pesë) kandidatë** dhe konkretisht: znj. {...} (Softa); znj. {...}; znj. Vojsava Osmanaj; z. {...} dhe z. {...}.

2.1. Konkretisht, kandidimet për këto pozicione të lira paraqiten në formë tabelare si më poshtë:

| Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 536, datë 17.11.2021 | Për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021 |
|--|--|
| {...}  | {...}  |
| {...}  | {...}  |
| {...}  | {...}  |
| {...}  | {...}  |
| {...}  | {...}  |

3. Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë ose të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë.

4. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të emërimit në Gjykatën e Lartë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësisimit nga secili kandidat të kritereve të më poshtme:

- 1) **“përvojës profesionale minimale”**, sipas pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës*

---

“Metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”; - Vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

*përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”;*

- 2) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”;*
- 3) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;*
- 4) **të pasurisë dhe figurës**, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

5. Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira të mbetura të Gjykatës së Lartë, Këshilli, si në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht atyre të *“përvojës profesionale minimale”*, të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”* dhe të *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas

verifikimit të të gjithë kritereve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

6. Gjatë procedurave të verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit, për një kandidat Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë*, në kushtet kur për atë u verifikua mosplotësimi i kriterit të “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*”.

6.1 Konkretisht, Këshilli i lartë Gjyqësor ka skualifikuar dhe përjashtuar nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë kandidatin:

(1) z. *{...}*, me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022, Këshilli vendosi *skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë*, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*”, ndërsa ndaj kandidatit ishte dhënë masa disiplinore “*shkarkim nga detyra*”, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndaj këtij vendimi, kandidati paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ndërkohë që kjo e fundit me vendimin nr. 37, datë 01.06.2022 vendosi rrëzimin e padisë.

7. Për 4(katër) kandidatë të tjerë, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të të gjitha kritereve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar. Konkretisht:

- 1) *Znj. {...}* – e cila ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Këshilli me vendimin nr. 130, datë 06.04.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në të cilat ka kandiduar;
- 2) *Znj. {...}* - e cila ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Këshilli me vendimin nr. 129, datë 06.04.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në të cilat ka kandiduar;
- 3) *Z. {...}* - i cili ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Këshilli me vendimin Nr. 174, 05.05.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në të cilat ka kandiduar;
- 4) *Znj. Vojsava Osmanaj* - e cila ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Këshilli

me vendimin nr. 175, 05.05.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në të cilat ka kandiduar;

8. Siç u parashtrua më lart, krahas procedurave të verifikimit të kritereve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht:

1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin;

2) vlerësimi i përsheptuar për vitin 2021, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019 ose vlerësimi periodik 2017-2019.

9. Ndërsa proceset e verifikimit të kritereve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 193, datë 27.05.2022, filloi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, ndër të tjera, edhe të atyre që kanë kandiduar për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e tij nr. 536, dhe nr. 537, datë 17.11.2022. Me këtë vendim, si relator i procedurave të përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi.

10. Më datë 27.05.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

11. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), relatori administroi dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar. Duhet përmendur se kandidatja, znj. {...} ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022 për vlerësimin etik dhe profesional të saj për vitin 2021. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si i tillë, vendimi nr. 537, datë 14.12.2022 konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

12. Këshilli më herët përfundoi procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 14.12.2022 duke i propozuar Presidentit të Republikës emërimin e znj. {...}. Në situatën e mësipërme, renditja e

kandidatëve dhe përzgjedhja me qëllim propozimin e tyre për emërim në Gjykatën e Lartë, vijoi edhe për të dy pozicionet e lira të shpallura më pas në rend kronologjik, që janë ato në fushën e të drejtës civile sipas Vendimeve të Këshillit nr. 536 dhe nr. 537 datë 17.11.2021, në rrethanat kur për kandidatët e këtyre pozicioneve të lira ka përfunduar procedura e verifikimit dhe për ata ka dy vlerësime etike dhe profesionale. Referuar pikës 46, të Vendimit 70/2020: *“Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë”*. Ndërkohë sipas pikës 52 të këtij vendimi: *“Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve”*.

13. Në funksion të procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet e Këshillit nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, relatori administroi tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për të katër kandidatët që ishin fillimisht në garë.

13.1. Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022 dhe nr. 537, datë 14.12.2022, vendime të cilët tashmë janë të formës së prerë.

13.1.1. Kandidatja, znj. {...} ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022 për vlerësimin etik dhe profesional të vitit 2021. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si i tillë, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

13.1.2. Ndaj vendimit nr. 536, datë 14.12.2022 nuk rezulton të jetë paraqitur ankim brenda afatit ligjor, referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë Këshillit me nr. 2519 prot., datë 25.04.2023.

13.2 Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 4, datë 16.01.2023 dhe nr. 161, datë 06.04.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur ankim. Sa më sipër rezulton nga deklarata e kandidatit, përmes komunikimit elektronik të datës 18.04.2023 (lidhur me vendimin nr. 161, datë 06.04.2023), në të cilën ka shprehur dakordësinë për vendimin. Lidhur me vendimin nr. 4, datë 16.01.2023, nuk rezulton të jetë paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit dhe protokolluar pranë Këshillit me nr. 2519 prot., datë 25.04.2023.

13.3 Për kandidatin z. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 456, datë 02.11.2022 dhe nr. 3, datë 16.01.2023. Këto vendime janë përfundimtarë, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë Këshillit me nr. 2519 prot., datë 25.04.2023.

13.4 Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 119, datë 15.03.2023 dhe nr. 230, datë 11.05.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë. Ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë Këshillit me nr. 2519 prot., datë 25.04.2023, si edhe nga komunikimi elektronik i kandidates datë 18.05.2023.

13.5. Siç është përmendur në paragrafin 12 të këtij vendimi, kandidatja znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021. Në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, me Vendimin nr. 212, datë 28.04.2023 Këshilli miratoi renditjen e kandidatëve, ku znj. {...} u rendit e para. Më tej, me vendimin nr. 270, datë 25.05.2023 Këshilli i propozoi Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë të znj. {...}. Kjo e fundit është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë me dekretin nr. 78, datë 06.06.2023, të Presidentit të Republikës. Nisur nga një rrethanë e tillë, kandidimi i znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e tjera, duke përfshirë edhe pozicionin nr. 537, datë 17.11.2021 tashmë ka mbetur pa objekt, ndaj ajo nuk u përfshi në vijim në procedurën e përzgjedhjes në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë.

14. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (*Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve*), të Vendimit 70/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë duke ndjekur rendin kronologjik të shpalljes së tyre.

15. Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajt në konsideratë pika 9 e Nenit 48 të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “9. *Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga këshillat; b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist”.*

16. Për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të pikës 9 të nenit 48 të Ligjit për Statusin, Vendimit nr. 70/2020 të Këshillit i dalë në zbatim të pikës 14 të nenit 48 të Ligjit për Statusin si dhe përcaktimit të bërë në nenin 149 pika 3 të Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008, i ndryshuar, në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë për vlerën e shtuar që merr gjyqtari si anëtar i Kolegjit Zgjedhor përgjatë kandidimit të tij në procedurën e ngritjes në detyrë.

## **II. RENDITJA E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E LIRË, NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 537, DATË 17.11.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

17. Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021, u përfshinë tre kandidatë, konkretisht: znj. {...}; z. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë/emërimin ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit 70/2020.

18. Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit nr. 70/2020.

19. Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

- a) Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;  
Sipas Vendimit të Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022, kandidatja është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;
- b) Për z. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 456, datë 02.11.2022, Kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;



Sipas Vendimit të Këshillit nr. 3, datë 16.01.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

- c) Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 230, datë 11.05.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;
- Sipas Vendimit të Këshillit nr. 119, datë 15.03.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

20. Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...} të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse dy kandidatët e tjerë, konkretisht znj. {...} dhe z. {...}, të kenë “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, identifikohen një kandidat me rezultate më të larta, konkretisht znj. {...}, e cila renditet më lart se dy kandidatët e tjerë. Nga ana tjetër, konstatohet se kjo kandidate, ndërsa është renditur më lart edhe për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, me Vendimin Paraprak të këtij Këshilli nr. 315, datë 14.06.2023, ajo është propozuar për emërim në këtë pozicion të lirë. Për rrjedhojë, u bë i domosdoshëm vijimi i procedurës së përzgjedhjes, për renditjen e dy kandidatëve të tjerë, lidhur me pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021.

21. Kriteret e përcaktimit të renditjes së kandidatëve për ngritje në detyrë parashikohen në neni 48 të Ligjit për Statusin si dhe në Vendimin nr. 70/2020 të Këshillit “Për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

21.1 Në vijim të shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, siç u parashtrua, përcaktohet se: “... duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ...”. Ndërsa në pikën 15, të Vendimit nr. 70/2020, përcaktohet se: “Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme: a) “niveli i vlerësimit të fundit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart; b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart; c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i

*Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart; ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart”.*

21.2 Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “*nivelit të vlerësimit të fundit*”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për dy kandidatët për znj. {...} dhe z. {...} u konstatua që kanë të njëjtin nivel vlerësimi, “*Shumë mirë*”, për vlerësimin e fundit etik dhe profesional, që është ai i vitit 2021. Për pasojë, rezultoi e pamundur renditja e kandidatëve sipas kësaj përparësie.

21.3 Referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “*përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit*”, Këshilli evidenton një situatë të veçantë për njërin nga kandidatët gjatë procedurës së përzgjedhjes. Konkretisht, u konstatua se njëri nga dy kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, z. {...} ka përvojë/kontribut të veçantë si gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor e cila vlerësohet si vlerë e shtruar për qëllime të ngritjes në detyrë pas përfundimit të periudhës së delegimit në bazë të nenit 149 pika 3 i Kodit Zgjedhor.

21.4 Z. {...} krahas detyrës së gjyqtarit në gjykatën e apelit Durrës në periudhën dhjetor 2012 deri në dhjetor 2016 është deleguar dhe ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Kolegjin Zgjedhor për një mandat 4 vjeçar. Në datën 07.12.2012 z. {...} është përzgjedhur gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor nëpërmjet shortit të zhvilluar sipas nenit 146 dhe nenit 147 të Kodit Zgjedhor në fuqi në atë kohë. Konstituimi i Kolegjit Zgjedhor duke përfshirë edhe z. {...} është bërë përpara Presidentit të Republikës nëpërmjet betimit të kryer në datë 27 Dhjetor 2012. Ai ka përfunduar ushtrimin e kësaj detyre në dhjetor 2016 referuar kohëzgjatjes 4-vjeçare të funksionimit të atij Kolegji Zgjedhor.

*Delegimi si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor dhe ndikimi që ka në një procedurë kandidimi për ngritje në detyrë të gjyqtarit.*

22. Kodi Zgjedhor në nenin 149/3 ka njohur si vlerë të shtuar për qëllime të ngritjes në detyrë “*përvojën si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor*”. Ky parashikim është shtuar me ligjin 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi më gusht 2020. Në këtë dispozitë parashikohet se: “3. Pas përfundimit të delegimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, ushtrimi i detyrës në këtë Kolegj konsiderohet vlerë e shtuar në përvojë për qëllime të ngritjes në detyrë.” Nisur nga ky përcaktim ligjor mbetet të vlerësohet nëse delegimi i z. {...} si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor sipas nenit 147 të Kodit Zgjedhor do të konsiderohet si vlerë e shtuar e përvojës në një procedurë kandidimi për ngritje në detyrë.

22.1. Siç rezulton nga faktet e parashtruara më lart, z. {...} është deleguar në funksionin e gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve që ka pësuar neni 149/3 i Kodit Zgjedhor që i ka dhënë këtij delegimi vlerë të shtuar për qëllime të ngritjes në detyrë të gjyqtarit. Ndaj është rasti të vlerësohet nëse vlera e shtruar për qëllime të ngritjes në detyrë e parashikuar nga ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me ndryshime të cilat kanë hyrë në fuqi në gusht 2020 (ligji është botuar në fletoren zyrtare nr. 143, datë 04.08.2020) duhet të njihet si përparësi në drejtim të konkurrimit të tyre për ngritje në detyrë për të gjithë gjyqtarët të cilët kanë shërbyer në Kolegjin Zgjedhor edhe përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, siç është rasti i z. {...}.

22.2. Vlera e shtuar e njohur me nenin 149/3 i Kodit Zgjedhor pas ndryshimeve të ligjit 101/2020, nuk shoqërohet me funksione dhe përgjegjësi shtesë që mund t’i ngarkoheshin anëtarit të Kolegjit Zgjedhor, pasi në fakt asnjë përgjegjësi e re shtesë nuk i është ngarkuar anëtarit të Kolegjit Zgjedhor në raport me vlerën e shtuar që i është njohur atij. Në këtë pikë, vlera e shtuar e përvojës së kandidatit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor për gjyqtarin që konkurren për ngritje në detyrë është njohje dhe vlerësim që ligjvënësi i ka bërë funksioneve dhe kontributeve shtesë që jep gjyqtari gjatë shqyrtimit prej tij çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjet për në Kuvendin e Shqipërisë, për Organet e Qeverisjes Vendore dhe me Referendumet, përgjatë një mandati të plotë delegimi.

22.3. Siç u parashtrua edhe më sipër z. {...}t kjo detyrë i është caktuar për shkak të ligjit. Ai ka shërbyer si anëtar i Kolegjit Zgjedhor edhe përgjatë periudhës që ka hyrë në fuqi Ligji për Statusin i cili ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2016.<sup>2</sup>

22.4. Nocioni dhe funksioni i *gjyqtarit të deleguar* si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, nuk ka ndryshuar nga hyrja në fuqi e Kodi Zgjedhor në vitin 2008. Megjithëse Kodi Zgjedhor është ndryshuar,<sup>3</sup> mekanizmi i përzgjedhjes nëpërmjet shortit nga KLD, fillimi i detyrës pas betimit, si edhe funksioni që kryen anëtarit i Kolegjit Zgjedhor nuk ka pësuar ndryshime të mëtejshme ligjore. Kjo detyrë buron nga ligji. Pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore nuk ka diskutime lidhur me vlerën e shtuar të delegimit të gjyqtarit në Kolegji Zgjedhor për qëllime të ngritjes në detyrë.

22.5. Duke interpretuar sistematikisht të dy dispozitat, nenin 48 pika 9 të Ligjit për Statusin, me pikën 2 të nenit 149 të Kodit Zgjedhor, rezulton se qëllimi i ligjvënësit ka qenë i njëjtë në të dy parashikimet ligjore me të njëjtën shkallë hierarkie. Ligjvënësi ka pasur të njëjtin qëllim në

---

<sup>2</sup><https://qzbz.gov.al/eli/fz/2016/208/737b374b-4689-4e8e-820e-d730ee5984bb;q=P%C3%8BR%20STATUSIN%20E%20GJYQATAR%C3%8BVE%20DHE%20PROKUROR%C3%8BVE%20N%C3%8B%20REPUBLIK%C3%8BN%20E%20SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B>  
Botuar në fletore zyrtare nr. 208, datë 07.11.2016.

<sup>3</sup> Ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020.

ndryshimet e Kodit Zgjedhor, duke i dhënë vlerë të shtuar përvojës si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor kandidatit që ka shprehur interesin e tij për ngritje në detyrë. Të njëjtin synim ka pasur ligjvënësi edhe tek Ligji për Statusin, kur parashikon rrethanat apo faktet juridike që pasjellin përparësi për efekt renditjeje për ngritje në detyrë referuar përvojave të tjera specifike, të tilla si : qenia e gjyqtarit në skeme delegimi, i komanduar, apo anëtar i Këshillit. Me parashikimin e nenit 149 pika 3 të Kodit Zgjedhor, ligjvënësi nuk bëri gjë tjetër, veçse parashikoi në ligjin specifik me të njëjtën shkallë hierarkie (i miratuar edhe ai me 3/5), një rrethanë tjetër përparësie që në këtë rast është vlera e shtuar e përvojës së kandidatit në konkurrim për qëllime të ngritjes në detyrë si anëtar i Kolegjit Zgjedhor , e cila i shtohet përparësive të parashikuara në Ligjin për Statusin.

22.6. Për rrjedhojë koncepti “vlerë e shtuar për qëllime të ngritjes në detyrë” sipas Kodit Zgjedhor ka të njëjtin kuptim dhe merr të njëjtën vlerë me atë të “përparësisë në renditje për ngritjen në detyrë”. Barasvlerësia e dy koncepteve “vlerë e shtuar në përvojë” dhe “përparësia në renditje” është evidente në parashikimet e nenit 43 pika 7 shkronja i) e Ligjit për Statusin, ku ligjvënësi me ndryshimet që i bëri kësaj dispozite me Ligjin nr. 50/2021, parashikoi si përparësi renditjeje për kandidatët që aplikojnë për lëvizje paralele, veç përvojës në pozicione të komanduara, skemën e delegimit, anëtarësinë në Këshill...etj, edhe qenien anëtar të Kolegjit Zgjedhor që i ka mbaruar mandati ose çdo pozicion tjetër që ligji e përcakton si vlerë të shtuar.

22.7. Kjo dispozitë ndryshoi nga ligjvënësi për shkak të një nisme për ndryshime ligjore, ku u përfshi edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që përvojat e trajtuara nga ligjvënësi si vlerë e shtuar apo përparësi për ngritje në detyrë, të ishin të njëjta edhe tek lëvizja paralele, në kushtet kur Kodi Zgjedhor e parashikonte shprehimisht përvojën e gjyqtarit anëtar të tij vetëm si vlerë të shtuar për qëllime të ngritjes në detyrë. Mosparashikimi i shprehur në Ligjin për Statusin si “përparësi renditjeje” edhe të “përvojës si gjyqtar të Kolegjit Zgjedhor” vjen nga diferenca kohore e miratimit të Ligjit për Statusin me ndryshimet ligjore të Kodit Zgjedhor. Kjo qasje ka qenë zgjidhje dhe qëllim i ligjvënësit për të mos rënë në përsëritje (dublim) të të njëjtit parashikim ligjor në dy ligje të ndryshme të të njëjtit rang hierarkik, qëndrim që edhe Këshilli ka mbajtur në propozimet e tij për ndryshimet ligjore të Ligjit për Statusin.

22.8. Nëse nuk do të konsiderohet vlerë e shtuar përvoja që ka pasur z. {...} si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, pasoja do të jetë diferenca në trajtim të një gjyqtari të Kolegjit Zgjedhor që i përfundon delegimi pas ndryshimeve që ka pësuar Kodi Zgjedhor me ligjin 101/2020, datë 23.07.2020, me gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor, që kanë ushtruar të njëjtin funksion, me të njëjtat detyrime dhe përgjegjësi ligjore deri përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve. Siç u përmend edhe më sipër, vlera e shtuar e përvojës si gjyqtar në Kolegjin Zgjedhor është njohje nga ana e ligjvënësit të kontributit të dhënë përgjatë mandatit të tij, kandidatit me qëllim ngritjen e tij në detyrë.

22. 9. “Përvoja si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor” pas përfundimit të delegimit në këtë detyrë, sikundër përvoja si i komanduar apo në skemë delegimi, janë kontribute shtesë të njohura tashmë nga ligji

si pjesë e zhvillimit të karrierës së gjyqtarit dhe nuk zhbëhen dot si e tilla. Kodi Zgjedhor nuk krijoi me nenin 149 pika 3 një marrëdhënie të re juridike, që të diskutohet efekti prapaveprues i tij. Kjo dispozitë nuk ka karakter procedural, por material, sepse lidhet me të drejtat që gjyqtari ka për shkak të statusit të tij dhe zhvillimit të karrierës. Për ligjin edhe për shkak të teknikës legislative të përdorur në formulimin e dispozitës, nuk ka rëndësi koha se kur kjo përvojë është fituar nga gjyqtari, para apo pas miratimit të Ligjit për Statusin apo Kodit Zgjedhor. Interpretimi i kundërt, duke e konsideruar vlerë të shtuar vetëm për gjyqtarët anëtarë të Kolegjit Zgjedhor pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin, apo pas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, do të zhvlerësonte gjithë kontributet në karrierën e gjyqtarëve, para se këto ligje të miratoheshin.

22.10 Të pranosh të kundërtën do të thotë të mos konsiderosh gjithë vitet e përvojës profesionale të gjyqtarit dhe shumëllojshmërinë e këtyre përvojave. Këtë qëndrim Këshilli e ka mbajtur edhe me rastin e miratimit të aktit të tij nënligjor, Vendimit nr. 70/2020, ku ka qartësuar mënyrën e të kuptuarit dhe të zbatuarit të ligjit për gjyqtarët e komanduar në pozicione të tjera brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor, duke konsideruar përparësi përvojën si gjyqtar të komanduar edhe për komandimet e përfunduara para hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin.

23. Vlen të theksojmë se z. {...} nuk është përfshirë në skemën e delegimit, si përparësi që njihet nga neni 48 i Ligjit për Statusin, por ai ka shërbyer si gjyqtar i deleguar, anëtar i Kolegjit Zgjedhor.

24. Pika 9 e Nenit 48 të Ligjit për Statusin, nuk parashikon diferencim në vlerësim ndërmjet mekanizimit të *komandimit* dhe *skemës së delegimit* si përparësi në procedurat e ngritjes në detyrë. I njëjti rregull vlen edhe në rastin e qenies së gjyqtarit anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Pra, së bashku me *mekanizmin e komandimit*, *skemës së delegimit* edhe vlera e shtuar e kontributit të gjyqtarit *si anëtar i Kolegjit Zgjedhor* merr përparësi në një proces ngritjeje në detyrë.

24.1. Në lidhje me *komandimin*, referuar rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” të miratuar me vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, Këshilli ndër të tjera ka parashikuar si përparësi në ngritjen në detyrë, edhe komandimin në çdo pozicion me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara Ligjit për Statusin.<sup>4</sup>

24.2. Në një situatë të ngjashme të rrethanave faktike, Këshilli gjatë procedurës së ngritjes në detyrë ka vendosur në favor të kandidatëve që u është njohur përparësia në kontributin e dhënë gjatë komandimit, përpara sesa kjo përparësi të konsiderohej avantazh në Ligjin për Statusin. Pra këto kontribute të përfituara nga komandimi u janë njohur gjyqtarëve si përparësi në procedurat e ngritjes në detyrë nga Këshilli, në çdo kohë, pa u lidhur ky kontribut me hyrjen në fuqi të Ligjit për Statusin.

---

<sup>4</sup> Kreu III, pika 7, germa “f”.

24.3. Më konkretisht në disa raste, Këshilli, bazuar në pikën 9 të nenit 48 të Ligjit për Statusin, si edhe në pikën 15 të Vendimit nr. 70/2020, ka ngritur në detyrë kandidatë të cilët kanë shprehur interes për të zhvilluar karrierën e tyre duke vlerësuar si përparësi komandimin që magjistratët kanë pasur përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin.<sup>5</sup>

*A vlen kjo qasje dhe praktikë e Këshillit për rastin e një kandidati i cili ka qenë i deleguar si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor?*

25. Meqenëse ligjvënësi i trajton në mënyrë të barabartë dhe të padiferencuar të dy mekanizmat e përparësisë si në Kodin Zgjedhor, ashtu edhe në Ligjin për Statusin, arrijmë në përfundimin se qëndrimi dhe trajtimi i çështjes nga Këshilli duhet të jetë i njëjtë. Ashtu siç Këshilli ka vepruar në rastin e kandidatëve që u është njohur përparësia e kontributit të dhënë në komandime, përpara se këto kontribute të njiheshin nga Ligji për Statusin si përparësi, e njëjta mënyrë dhe i njëjti standard duhet të zbatohet edhe për vlerën e shtuar të kontributit të dhënë nga gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor.

25.1. Rrjedhimisht, delegimi i kandidatit si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor përpara ndryshimeve të Kodit Zgjedhor me Ligjin nr. 101/2020 në procedurat e ngritjes në detyrë nuk duhet të përjashtohet si vlerë e shtuar, edhe kur delegimi i tij është bërë para hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin dhe ndryshimeve të Kodit Zgjedhor.

25.2. Në këto rrethana, vlera e shtuar për qëllime të ngritjes në detyrë të gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor që i ka përfunduar mandati sipas nenit 149/3 të Kodit Zgjedhor është të barasvlershme me përparësinë e dytë për kriterin e parë të renditjes, të njohur nga Ligji për Statusin, pra asaj sipas *“përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”*. Kjo përvojë është vlerë e shtuar në funksion të kandidimit të tij për ngritje në detyrë e barasvlershme me kriterin e përparësive në renditje që përfiton kandidati në konkurrim sipas nenit 48 të ligjit për Statusin.

25.3. U konstatua se njëri nga dy kandidatët me rezultate, të njëjta në lidhje me nivelet e vlerësimit etik dhe profesional, ka përvojë të tillë, konkretisht z. {...} në periudhën dhjetor 2012 deri në dhjetor 2016 ka qenë i deleguar si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor dhe e ka përfunduar ushtrimin e kësaj detyre sipas mandatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

26. Në pikën 8, të Vendimit 70/2020, përcaktohet se: *“Renditja e kandidatëve bëhet me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për pozicionin e lirë”*. Kurse në pikën 15, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme: ...; b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart; ...”*. Sikundër u arrit në

---

<sup>5</sup> Për më tepër shiko vendimet e Këshillit nr. 81, datë 09.03.2021 dhe nr. 164, datë 05.05.2022.

konkluzionet e paragrafëve 25.2 dhe 25.3 të këtij vendimi përparësitë e përcaktuara në pikën 15 të Vendimit nr. 70/2020 janë të barasvlershme me vlerën e shtuar që neni 149/3 i Kodit Zgjedhor i njeh kontributit të dhënë nga kandidatët si gjyqtarë të Kolegjit Zgjedhor.

27. Nisur nga përcaktimet e mësipërme të Vendimit nr. 70/2020, nga zbatimi i përparësisë/vlerës së shtuar të përvojës si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor, i barasvlershëm me përparësinë e dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “*përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit*”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, që është z. {...}. Mbi këtë bazë realizohet renditja e dy kandidatëve me rezultate të njëjta, në lidhje me nivelet e vlerësimit etik dhe profesional, ku më lart renditet kandidati z. {...}, ndërsa kandidatja tjetër znj. {...} renditet pas tij.

28. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Z. {...};
- 3) Znj. {...}.

28.1. Në nenin 48, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “... 11. *Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kriterëve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni. 12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. ... 13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës”.*

28.2. Në shkronjën “m”, pika 7, të Vendimit nr. 70/2020, përcaktohet se: “*Vendim paraparak i propozimit për emërim*”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për renditjen e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe propozimin për emërim të kandidatit të renditur më lart”. Kurse në pikën 8, të këtij vendimi, përcaktohet se: “*Renditja e kandidatëve bëhet me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për pozicionin e lirë*”.

28.3. Siç u parashtrua edhe më sipër, kandidatja e renditur më lart, znj. {...} rezultoi e renditur më lart edhe për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, shkak për të cilin, me Vendimin Paraparak të këtij Këshilli nr. 315 datë 14.06.2023, ajo u propozua për emërim në këtë pozicion të lirë. Nisur nga një rrethanë e tillë, kjo kandidate nuk mund të propozohet përsëri për emërim në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin tjetër të lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 537 datë 17.11.2021. Ligji lejon konkurrimin për ngritjen në detyrë apo emërimin në Gjykatën e Lartë për

jo më shumë se tre pozicione të lira (pika 6, e nenit 48, të Ligjit për Statusin), por kjo nuk nënkupton që një kandidat mund të ngrihet në detyrë apo të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë në më shumë se një pozicion të lirë. E drejta dhe interesi i ligjshëm i kandidatit konsiderohet i përmbushur me ngritjen në detyrë apo propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë për një nga pozicionet e lira ku ka kandiduar dhe në rastin kur ka shprehur preferenca në momentin e kandidimit, në pozicionin sipas preferencës së parë. Nga ana tjetër, interesi publik është plotësimi i çdo pozicioni të lirë në një gjykatë, për më tepër kur bëhet fjalë Gjykatën e Lartë, nevoja për sigurimin e funksionalitetit maksimal të saj është më se e evidente.

28.4. Për rrjedhojë, z. {...} mbetet për t'u propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021, si kandidati i renditur pas znj. {...}.

28.5. Bazuar në sa më sipër relatori përgatiti projektvendimin paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

28.6. Projektvendimi paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 02.06.2023, sikurse përcaktohet në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidatët në këtë procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

### **III. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

29. Projektvendimi paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Seksionin Ç, Kreu VI, të Vendimit 70/2020.

30. Më tej, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi të plotë dhe të drejtë ndjekjen nga relatori të hapave, kritereve dhe përparësive të renditjes së kandidatëve, përcaktuar në pikën 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Kreun IV, të Vendimit 70/2020, nxjerrë në zbatim të tij sipas pikës 14, të këtij ligji.

31. Këshilli i Lartë Gjyqësor po ashtu vlerësoi si të saktë renditjen nga relatori të kandidatëve që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë, emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në



fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 537, datë 17.11.2021, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatët në funksion të procedurës së përzgjedhjes.

32. Së fundi, Këshilli i Lartë Gjyqësor e vlerësoi të drejtë edhe propozimin e relatorit sa i përket kandidatit i cili duhet t'i propozohet Presidentit të Republikës për emërimin në Gjykatën e Lartë, pra të kandidatit z. {...}.

#### **IV. KONKLUZIONI**

31. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin pa ndryshime të projektvendimi paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenet 136, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 85, 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 12 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes, Këshilli i Lartë Gjyqësor

#### **V E N D O S I :**

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Z. {...};
- 3) Znj. {...}

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**